



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VIII**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal  
Mbledhja nr. 68  
Prishtinë, më 21 qershor 2024, në orën: 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Valon Ramadani, Isak Shabani, Fidan Jilta, Adelina Grainca, Nijazi Isaku, Besim Muzaqi, Fitim Haziri, Mergim Lushtaku dhe Agim Veliu.

Mungoi: Besnik Tahiri.

Në mbledhje morën pjesë: OSBE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi Valon Ramadani, kryetar i komisionit, me këtë:

**Rend të ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media;
3. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin nr.08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L- 031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë;
4. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik;
5. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i rendit të ditës,**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

## **2. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media;**

**Valon Ramadani**, njoftoi komisionin se në pajtim me vendimin e Kuvendit nr. 08-V-698, datë 07 mars 2024, Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal në mbledhjet e mbajtura me 07.02, 26.04 dhe 27, 28, dhe 30.05.2024, shqyrtoi dhe amendamentoi Projektligjin nr. 08/L-289 për KPM, dhe të njëjtin e ka proceduar për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet e përhershme.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në mbledhjen e mbajtur me 05.06.2024, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentet e propozuara për Projektligjin për KPM-në dhe vlerësoi se projektligji përmban implikime buxhetore shtesë, por të përballeshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës, ndërsa amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, në mbledhjen e mbajtur me 07.06.2024, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentet e propozuara për Projektligjin për KPM-në dhe vlerësoi se projektligji dhe amendamentet janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në mbledhjen e mbajtur me 07.06.2024, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentet e propozuara për Projektligjin për KPM-në dhe vlerësoi se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Integrim Evropian, në mbledhjen e mbajtur me 19.06.2024, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentet e propozuara për Projektligjin për KPM-në dhe vlerësoi se projektligji dhe amendamentet e propozuara janë pjesërisht në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit nr. 08-V-698, datë 07 mars 2024 vendosi që për shqyrtimin e Projektligjit, Kuvendit ti paraqes raportin me amendamente. Raporti për Kuvend përmban gjithsejt 93 amendamente.

Kush është për procedimin e raportit me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-289 për KPM?

**Konstatim:** Komisioni me 6 vota “Për” procedoi Raportin me amendamente për shqyrtim të dytë në seancë plenare.

**3. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin nr.08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L- 031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë;**

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, në pajtim me vendimin e Kuvendit nr. 08-V-689, 22 shkurt 2024, në mbledhjet e mbajtura me 07.12.2023 dhe 21.03.2024, shqyrtoi dhe amendamenti Projektligjin nr.08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L- 031 për procedurën e përgjithshme administrative faza e dytë, dhe të njëjtin e ka proceduar për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet e përhershme.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në mbledhjen e mbajtur me 03.04.2024, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentin e propozuar në Projektligjin nr.08/L - 262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L- 031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë dhe vlerësoi se projektligji dhe amendamenti i propozuar nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, në mbledhjen e mbajtur me 04.04.2024, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentin e propozuar në Projektligjin nr.08/L - 262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L- 031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë dhe vlerësoi se projektligji dhe amendamenti i propozuar janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në mbledhjen e mbajtur me 04.04.2024, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentin e propozuar në Projektligjin nr.08/L - 262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L- 031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë dhe vlerësoi se projektligji dhe amendamenti i propozuar nuk i cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Integrim Evropian, në mbledhjen e mbajtur me 25.04.2024, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentin e propozuar në Projektligjin nr.08/L - 262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L- 031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë dhe vlerësoi se projektligji dhe amendamenti i propozuar nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit nr. 08-V-689, dt. 22 shkurt 2024, vendosi që për shqyrtimin e

Projektligjit, Kuvendit ti paraqes raportin me amendamente. Raporti për Kuvend përmban 1 amendament.

Kush është për procedimin e raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L- 031 për procedurën e përgjithshme administrative faza e dytë?

**Konstatim:** Komisioni me 6 vota “Për” procedoi Raportin me amendamente për shqyrtim të dytë në seancë plenare.

#### **4. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik;**

**Valon Ramadani**, njoftoi komisionin se në pajtim me Vendimin e Kuvendit nr. 08-V-716, datë 25 prill 2024, Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, në mbledhjet e mbajtura me 29.03 dhe 28.05.2024, shqyrtoi dhe amendamentoi Projektligjin nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe të njëjtin e ka proceduar për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet e përhershme.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në mbledhjen e mbajtur me 05.06.2024, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentet e propozuara për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe vlerësoi se projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, në mbledhjen e mbajtur me 06.06.2024, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentet e propozuara për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe vlerësoi se projektligji dhe amendamentet janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në mbledhjen e mbajtur me 07.06.2024, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentet e propozuara për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe vlerësoi se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Integrim Evropian, në mbledhjen e mbajtur me 19.06.2024, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentet e propozuara për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe vlerësoi se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk rregullohen në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit nr. 08-V-716, datë 25 prill 2024, vendosi që për shqyrtimin e Projektligjit, Kuvendit ti paraqes raportin plotësues me amendamente. Raporti për Kuvend përmban gjithsejt 2 amendamente. Raporti plotësues është hartuar vetëm për çështje teknike, se ku duhet të radhiten amendamentet në P/ligj, nuk ka ndërhyrje përmbajtësore.

Kush është për procedimin e raportit me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrarët Publik?

**Konstatim:** Komisioni me 6 vota “Për” procedoi Raportin me amendamente për shqyrtim të dytë në seancë plenare.

## **5. Të ndryshme.**

Pasi që, për pikën të ndryshme nuk pati diskutime, mbledhja përfundoi.

Mbledhja përfundoi në orën: 12:30.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Valon Ramadani,**

**Kryetar i Komisionit**

---